




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	285/17
Nr. i sq. / Br. st	~ 8 ~
Data: / Datum	28.03.2017
VUSHTRRI - VUČITRN	



KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

RREGULLORE (KKV) NR.03/2017

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIN E BIBLIOTEKËS "NAIM FRASHËRI", SI DHE NËNDEGËVE TË SAJ NË TERRITORIN E VUSHTRRISË

Shtator, 2017

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat, nenit 5 të Rregullores Nr. 01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave, nenit 4 të Rregullores Nr.02/15 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit dhe funksionalizimit të bibliotekave, si dhe nenit 41, pika 2, shkronja (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë **28 shtator 2017**, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIN E BIBLIOTEKËS “NAIM
FRASHËRI”, SI DHE NËNDEGËVE TË SAJ NË TERRITORIN E VUSHTRRISË**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe kriteret e veprimtarisë të punës së bibliotekës komunale “Naim Frashëri” (në tekstin e mëtejmë, biblioteka) dhe nëndegët e saj në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret e përgjithshme për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të bibliotekës dhe nëndegëve të saj, duke përfshirë hapësirën bibliotekare, inventarin e bibliotekës, rregullimin e librave, stafin profesional, pagesat për shfrytëzimin e fondit librar në bibliotekë dhe buxhetin.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

- 1.1. **Bibliotekat** –Institacione kulturore, arsimore dhe informuese që mbledhin, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta, ofrojnë qasje të lirë në informacione në ciládo forma që janë depozituar;
- 1.2. **Koleksion bibliotekar** – Tërësia e materialeve të regjistruara, të përpunuara dhe të depozituara;
- 1.3. **Material bibliotekar** – përfshin: Botimet e veprave dhe të materialeve të shtypura e grafike, siç janë: inkunabulat, librat e reja, të vjetra, raritetet, dorëshkrimet, broshurat, revistat, gazetat, publikimet zyrtare, riprodhimet e veprave të artit vizual, riprodhimet e veprave hartografike, riprodhimet e veprave urbanistike, veprat muzikore, materialet e reprografoara, pllakatet, afishet, fotodokumentet, fonodokumentet, regjistrimet pamore e filmike, veprat e tjera të reporoduktuara me anë të shtypit ose në një mënyrë tjetër, si dhe

- materialet e reja që nënkuptojnë doktoratat dhe magjistraturat, fotokopjet dhe materialet e memorizuara në formë të shtypur, elektronike dhe të tjera;
- 1.4. **Materiali bibliotekar burimor** – dorëshkrimi, materiali i shtypur ose i krijuar në ndonjë formë tjetër, që ka vlerë dokumentare për kulturën, artin dhe shkencën, siç janë raritetet, materiali i vjetër, kopje e arkivuar e botimit;
 - 1.5. **Përdorues** – personi, të cilit biblioteka i ofron informacionin dhe i jep në përdorim materialin bibliotekar;
 - 1.6. **Shërbimi bibliotekar** – përfshin dhënien e librave dhe materialeve të tjera për shërbim në bibliotekë, shërbimet informuese përmes katalogëve manual dhe elektronikë, shërbimet orientuese dhe referuese për gjetjen e informacionit, shërbimet për të ndihmuar përdoruesin në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
 - 1.7. **KUD** – Klasifikimi Universal Decimal është një udhëzues, i cili mundëson klasifikimin e njojurive njerëzore në nëntë (9) disiplina apo lëmi;
 - 1.8. **Ministër** – nënkupton udhëheqësin e ministrisë përkatëse për kulturë
 - 1.9. **Ministri** – nënkupton organin qendror të administratës shtetërore, që drejton një fushë të caktuar të veprimtarisë (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit).

Neni 4 Objekti i bibliotekës

1. Deri në ndërtimin e një objekti të veçantë të bibliotekës amë, hapësira ku qëndron stafi punues, fondi librar dhe pajisjet tjera të nevojshme bibliotekare, gjenden në Q. K. “Hasan Prishtina” në Vushtrri.
2. Për mirëmbajtjen, pastërtinë dhe nevojat tjera specifike tekniko – sanitare, sa është biblioteka në Q. K. “Hasan Prishtina”, përkujdesen punëtorët teknik të Q. K., të cilët i mbikëqyr drejtori i Q. K.

Neni 5 Vulat dhe stema e bibliotekës

1. Biblioteka ka status të institucionit kulturor publik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me ligj, Statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
2. Pasuria e bibliotekës është pronë e komunës.
3. Në ballinën hyrëse të objektit të bibliotekës vendoset mbishkrimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhët zyrtare, të cilat parashihen me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
4. Biblioteka “Naim Frashëri” nuk ka xhirollogari të veçantë bankare. Mjetet e mbledhura nga lexuesit e regjistruar, alokohen në xhirollogarinë e Komunës së Vushtrrisë.

5. Biblioteka ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore, të cilat përdoren për protokollimin e shkresave zyrtare.

6. Vula e rrumbullakët është me diametër 4 cm, në 3 rrathë koncentrik dhe përmban këto të dhëna:

- 6.1 Në rrethin e parë, të jashtëm, shkruhet: Republika e Kosovës,
- 6.2 Në rrethin e dytë shkruhet: Komuna e Vushtrrisë, Vushtrri,
- 6.3 Në rrethin e tretë shkruhet: Biblioteka “Naim Frashëri”,
- 6.4 Në sipërfaqen e mbetur, brenda rrethit të tretë të vulës, vendoset stema e bibliotekës,
- 6.5 Teksti i vulës është me shkronja të mëdha shtypi, në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhën zyrtare të Kosovës.

7. Vula katrore e protokollit është e madhësisë 6 x2.5 cm, me këto të dhëna sipas renditjes:

- 7.1 Republika e Kosovës,
- 7.2 Komuna e Vushtrrisë,
- 7.3 Biblioteka “Naim Frashëri”,
- 7.4 Numri i protokollit i njësisë organizative, në vazhdim lihet hapësira për shënimin e numrit të protokollit të shkresës.

8. Stema e bibliotekës ka këtë përbërje: sfondin e bardhë, një libër i hapur, mbi libër të hapur është mbishkrimi “Naim Frashëri”, kurse nën libër Komuna Vushtrri, si dhe është e formës katrore.

Neni 6

Detyrat dhe kompetencat e bibliotekës

1. Biblioteka e komunës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- 1.1. Koordinimi i punëve profesionale i degëve brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, duke e ndarë fondin e librave dhe koleksioneve bibliotekare proporcionalisht, bazuar në kërkzesat e lexuesve;
- 1.2. Ofrimi i qasjes në materialet bibliotekare për të gjithë shfrytëzuesit e saj brenda territorit të komunës dhe më gjerë;
- 1.3. Bashkëpunimi në përpilimin e katalogut elektronik me bibliotekën kombëtare “Pjetër Budi” në Prishtinë dhe ofrimin e tij në dispozicion të përdoruesve;
- 1.4. Përveç bashkëpunimit me bibliotekat e tjera në komuna të Kosovës, bashkëpunon edhe me biblioteka ndërkombëtare;
- 1.5. Organizon aktivitete kulturore dhe edukative në ambientet e bibliotekës apo edhe jashtë saj (varësisht nga aktiviteti) siç janë: ekspositat e librit, promovime, tribuna, tryeza, debate me krijues, orë letrare dhe veprimtari tjera bibliotekare.

- 1.6. Bashkëpunon me institucione kulturore, shtëpi botuese, shkolla, universitete dhe komunitetin, me qëllim të nxitjes së interesimit për librin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- 1.7. Prezantim i shërbimeve dhe veprimtarive të saj për publikun përmes ueb – faqes, katalogëve, fletushkave e formave radio dhe TV emisioneve dhe formave tjera të informimit.
- 1.8. Përpilimi dhe botimi i publikimeve profesionale, si: katalogë, doracakë, fletëpalosje, revista etj, në pajtim me Ligjin mbi bibliotekat.
- 1.9. Në koordinim me sektorin e kulturës të DKRS-së, harton projekte e programe për zhvillimin e rrjetit bibliotekar të degëve të bibliotekës.
- 1.10. Huazimi, këmbimi dhe dhurimi (nëse ka ekzemplarë të mjaftueshëm dhe që nuk ka nevojë të zënë vend në raftet e bibliotekës) i materialeve bibliotekare për t'i përbushur nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve;
- 1.11. Mbledhja e informacioneve dhe materialeve brenda territorit të komunës, të cilat i ruan dhe i ofron në shërbim të përdoruesve;
- 1.12. Shfrytëzimi i literaturës së digitalizuar, bazuar në teknologjinë e hapur;
- 1.13. Ushtron edhe veprimtari të aktivitete të tjera në pajtim me ligjin, me këtë rregullore dhe me politikat zhvillimore të sektorit të kulturës së DKRS-së.

Neni 7 **Organizimi i bibliotekës**

1. Biblioteka është e ndarë në dy sektore:
 - 1.1. Sektori për fëmijë,
 - 1.2. Sektori për të rritur.
2. Biblioteka i ka edhe nëndegët në këto fshatra: Dumnicë e Llugës, Maxhunaj, Samadrexhë, Smrekonicë, Shtruherë dhe Pantinë.
3. Personi që udhëheq në bibliotekat sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, është udhëheqësi i sektorit të bibliotekës.

Neni 8 **Financimi i bibliotekës**

1. Me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë së vet dhe kryerjen e punëve, biblioteka mjetet i siguron nga:

- 1.1 Buxheti i komunës;

- 1.2 Të ardhurat nga anëtarësimi i shfrytëzuesve të shërbimeve bibliotekare në bibliotekën e komunës;
- 1.3 Të ardhurat nga donacionet, fondacionet, bizneset, OJQ-të e themeluara në Kosovë dhe jashtë saj, nga individë që dëshirojnë të ndihmojnë bibliotekën, nga shërbimet me pagesë, të cilat do të shfrytëzohen për pasurimin e fondit librar dhe koleksioneve tjera të bibliotekës, dhe nga
- 1.4 Burimet e tjera të parapara me ligj, me aktet e tjera nënligjore dhe me këtë rregullore.

Neni 9
Tarifat për anëtarësim në bibliotekë

1.Tarifat për anëtarësim në bibliotekë janë më sa vijon:

- 1.1 Lexuesi, nxënës parafillor dhe i shkollës filllore (klasa I – V) lirohet nga pagesa.
- 1.2 Lexuesi, nxënës i shkollës së mesme të ulët (VI – IX), shkollës së mesme të lartë (X – XII), studentë dhe të tjerë paguajnë 2 euro për një vit;
- 1.3 Prej pagesës së anëtarësisë lirohen: Të gjithë anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, veteranëve, invalidëve të luftës dhe martirëve; lexuesit (nxënësit) e shkollave filllore (klasa I – V), si dhe vullnetarët e pajisur me libreza të vullnetarizmit;
- 1.4 Nga pagesa lirohen edhe ata persona që në mënyra të ndryshme kanë ndihmuar bibliotekën apo kanë zhvilluar aktivitete të rëndësishme në kuadër të DKRS-së. Kjo përcaktohet nga DKRS-ja në koordinim me menaxherin e bibliotekës;
- 1.5 Pagesa bëhet për një vit. Viti llogaritet nga dita e regjistrimit të lexuesit në bibliotekë;
- 1.6 Punëtori i autorizuar i bibliotekës i evidenton pagesat me bllok serik të vërtetuar nga Kuvendi Komunal – Vushtrri.

Neni 10
Afati i kthimit të librave

1. Lexuesi i regjistruar në bibliotekë, librin e lejuar për të marrë në shtëpi, është i obliguar që ta kthejë brenda njëzetë e një (21) ditëve.
 2. Libri konsiderohet i humbur nëse nuk kthehet në bibliotekë brenda katër javëve, nga dita e parë e marrjes së librit.
- 1.1. Në rast moskthimit të librit me kohë, të përcaktuar me paragrafin 1 të këtij nenit, bibliotekisti duhet ta njoftojë udhëheqësin e sektorit të bibliotekës;

1.2. Lexuesit që nuk i kthejnë librat me kohë e humbin të drejtën e furnizimit me libra në periudhën prej gjashtë (6) muajve;

1.3. Lexuesi që e humb librin, është i detyruar që në afatin prej 30 ditësh, ta blejë librin e njëjtë dhe ta sjellë në bibliotekën përkatëse.

3. Librat shkencorë, librat që kanë vlerë të veçantë dhe librat që janë të rrallë (me listë të veçantë) nuk lejohen të dalin nga biblioteka, por mund të shfrytëzohen vetëm në sallën e leximit të bibliotekës.

4. Për shfrytëzim të librave shkencorë, si garancion për kthimin e librit, lexuesit detyrohen të dorëzojnë dokumentin e identifikimit.

Neni 11 Mënyra e përdorimit të materialeve bibliotekare

1. Stafi i bibliotekës duhet t'i udhëzojë përdoruesit lidhur me përdorimin e drejtë të materialit bibliotekar.

2. Në hapësirat ku përdoret materiali bibliotekar ndalohet:

- 2.1. Pirja e pijeve alkoolike e substancave narkotike;
- 2.2. Pirja e duhanit;
- 2.3. Ngrënia e ushqimit;
- 2.4. Zhurma.

Neni 12 Vendosja dhe renditja e materialeve bibliotekare

1. Materialet bibliotekare vendosen në rafte metalike ose nga druri.

2. Koleksionet librare duhet të renditen në pozitë vertikale në rafte, të mbështetura nga libra të tjera me mbajtëse metalike.

Neni 13 Përgjegjësit për zbatimin e kësaj rregulloreje


Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet sektori i bibliotekës, ndërsa monitorimin e zbatimit të saj e bën DKRS-ja.

Neni 14
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet pika 1, alineja a, b, c dhe d të nenit 18 të Rregullores me numër 278/15 të datës 30.12.2015 për tarifa dhe ngarkesa komunale.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit